



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

Komisioni Komunal i aksionarëve të "Stacionit të Autobusëve" në Istog, në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2, dhe nenit 16 të Ligjit të Ligjit nr. 03/L-87 për ndryshim plotësim të Ligjit Nr.04/L-111 ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës nr.31.dt.15 qershor 2008) e ri shpall këtë:

## KONKURS

**Titulli i vendit të punës:** Drejtor në Bordin e Drejtorëve në "Stacionin e Autobusëve" në Istog

Numri i pozitës: 4 (katër) kryerëse

Kohëzgjatja e mandatit ; 3 (tri) vjeqare

Vendi i punës: Stacioni i Autobusëve në Istog

Datë : 10.07.2024.

### Detyrat dhe përgjegjësit:

-Administron dhe ushtron mbikqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë, në veçanti të veprimtarisë së zyrtarëve të N.P.L. dhe merr vendim për N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

-Zgjedh dhe zëvendëson, shkarkon Kryeshefin Ekzekutiv të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve"

-Aprovon Planin, Raportin e punës dhe Raportin Financiar të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" në Istog për periudhat e caktuara kohore dhe njëherit rekomandimet për aprovim këto raporte tek K.K.A. dhe Kuvendi i Komunës.

-Miraton dokumente si: rregulloret e brendshme, skemën organizative dhe sistematizimin e vendeve të punës,

-Propozon ndërmarrjen e hapave të ndryshëm për administrim sa më të mirë të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve"

-Për punët e veta Bordi i përgjigjet K.K.A. dhe Kuvendi i Komunës

### Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë Universitare

### Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

-Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - në një nivel të lartë të menaxhimit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporatave, financa, menaxhim të thesarit banka, konsulent në biznes ose në industri ose nga një fushë tjetër e shkencave ose njohurive e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste në N.P. ose së paku 5 vjet të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar ose anëtar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të N.P.

-Drejtor në bordin e Drejtorëve të NP.L. "Stacioni i Autobusëve" duhet të jetë person me inegritet të dëshmuar i cili i plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1 dhe 17.2 të Ligjit nr. 03/L-87 për ndryshim plotësim të Ligjit Nr.04/L-111 ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike.

-Të ketë shkathhtësitë menaxhuese,

- Të ketë njohuri për punën me kompjuter (MS, Word, Exel, etj).
- Njohje e gjuhëve zyrtare e domosdoshme ,
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe punës me kompjuter do të konsiderohet përparësi.

**Kandidatët e interesuar për këtë pozitë, kërkesës duhet ti bashkangjitin:**

- CV-në
- Certifikata e lindjes
- Dëshmi të kualifikimeve shkollore,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Dokument identifikimi,
- Certifikata që nuk është nën hetime dhe
- Letër motivuese.

Dokumentet e nevojshme dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë të Komunës së Istogut ose përmes postës.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e Informimit Publik.

Inkurajohen të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpresim kërkesat nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Komisioni Komunal i Aksionarëve**  
Abedin Kabashi

